



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të KQZ-së Nr.01/2017, për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, më 05.07.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIMOZA KADRIU** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gjilan, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **Adelina Berisha**.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Gjilan, që ky vendim t'i komunikohet **Mimoza Kadriut**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.


Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të kërkesës së Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Gjilan, të datës 03.06.2017, Nr.880/2017, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Adelina Berisha, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës. Duke u bazuar në deklaratën e pranimin të mandatit të kandidatës të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është Mimoza Kadriu, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 05.07.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka